



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 258/6 prot.

Tiranë, më 24.03.2026

V E N D I M

Nr. 22, datë 24.03.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË PROCESIT
TË ECURISË DISIPLINORE, NË INSTITUCIONIN E BASHKISË KOLONJË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses Eltona Josifi, në institucionin e Bashkisë Kolonjë,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresën nr. 258 prot., datë 09.02.2026, të paraqitur nga nëpunësja Eltona Josifi, me detyrë “Specialiste e Financës”, në Drejtorinë e Ekonomisë, Buxhetit dhe Financës, pranë institucionit të Bashkisë Kolonjë, në të cilin ngrihen pretendime për parregullsi të lejuara/kryera në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së procedurës disiplinore, në përfundim të së cilës është dhënë masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, në ngarkim të saj.

Në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, parashtrohet se, me aktin nr. 05 (nr. 794 prot.), datë 02.02.2026, “Vendim Përfundimtar”, të Komisionit të Disiplinës, në ngarkim të nëpunëses Eltona Josifi është dhënë masë disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për shkeljet e parashikuara në nenin 57, pika 1, germa a) dhe pika 2, germa a), b), c) dhe ç), të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në informacionin e dërguar, nëpunësja pretendon se, gjatë zhvillimit të ecuresë disiplinore në ngarkim të saj, nga ana e Komisionit të Disiplinës, janë lejuar shkelje të ligjit në disa drejtime:

Së pari, nuk është njoftuar paraprakisht në përputhje me kërkesat ligjore që rregullojnë institutin e disiplinës, se ndaj saj ka filluar një ecuri disiplinore.

Së dyti, sa i përket aktit nr. 49, (nr. 835 prot.), datë 03.02.2026, të Kryetarit të Bashkisë “Për shkarkimin nga detyra të specialistes së financës”, nxjerrë në ngarkim të saj, pretendohet se, janë ndërprerë në mënyrë të padrejtë marrëdhëniet e punës pranë kësaj bashkie, nga titullari i institucionit, në kapërcim të kompetencave të tij.

Në këto kushte, nëpunësja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e subjekteve të ngarkuara nga ligji, gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, që në këtë rast është Komisioni i Disiplinës, si dhe ligjshmërisë së Urdhrit nr.49, (nr.835 prot.), datë 03.02.2026, të Kryetarit të Bashkisë, “Për shkarkimin nga detyra të specialistes së financës”, nëpërmjet të cilit është liruar nga detyra nëpunësja E. Josifi, nxjerrë në zbatim të vendimit të Komisionit të Disiplinës.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara, ashtu si u evidentua më sipër, vlerësoi se ka dyshime të arsyeshme për parregullsi të lejuara gjatë administrimit të shërbimit civil, e në këto rrethana ka filluar procesin e verifikimit të informacionit. Nëpërmjet shkresës nr. 258/2 prot., datë 17.02.2026, “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të administruar me shkresën nr.258 prot., datë 09.02.2026, dërguar nga nëpunësja Eltona Josifi, institucioni Bashkia Kolonjë”, Komisioneri, ka njoftuar institucionin për fillimin e verifikimit të kësaj procedure disiplinore, duke i kërkuar dokumentacionin në të cilin është materializuar ajo.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Kolonjë, me shkresën nr. 1210/1 prot., datë 19.02.2026, me objekt: “Vënie në dispozicion e dokumentacionit mbi procedurën disiplinore të nëpunësit civil znj. Eltona Josifi”, e protokolluar pranë Komisionerit me nr.258/3 prot., datë 23.02.2026, ka dërguar dokumentacionin përkatës nga përmbajtja e të cilit, rezulton se, me aktin nr. 5555 prot., datë 25.11.2024, të njësisë përgjegjëse, nëpunëses

Eltona Josifi, emëruar në pozicionin “*Specialiste Finance*” në Drejtorinë e Financës, i është deklaruar statusi i punësimit si “*nëpunës civil*”.

Në vijim të marrëdhënies së punës në këtë pozicion ndaj nëpunëses në fjalë, me aktin nr.05, (nr. 794 prot.), datë 02.02.2026, “*Vendim përfundimtar*”, të Komisionit të Disiplinës, është dhënë masa disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, për shkelje të parashikuara në nenin 57, pika 1, germa a) dhe pika 2, germa a) b), c), ç) të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Sa i takon ligjshmërisë së dhënies së kësaj mase disiplinore, vlerësojmë se duhet të analizohet baza ligjore që e rregullon këtë institut të ligjit.

Konkretisht, në nenin 57, “*Përgjegjësia për masat disiplinore*”, përcaktohet përgjegjësia e nëpunësit civil për shkeljen me faj të detyrimeve sipas ligjit, si edhe kategorizimi i shkeljeve në:

a) shkelje shumë të rënda; b) shkelje të rënda; c) shkelje të lehta.

Më tej, në pikën 2, të këtij neni, parashikohet kategorizimi i shkeljeve shumë të rënda; në pikën 3, i shkeljeve të rënda dhe në pikën 4, i shkeljeve të lehta.

Ndërsa, në nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, parashikohen “*Llojet e masave disiplinore*” të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, në një rast kur evidentohen shkelje disiplinore:

“*Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil janë:*

a) *vërejtje;*

b) *mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj;*

c) *pezullim nga drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.*

ç) *largim nga shërbimi civil*”,

dhe në nenin 59, të këtij ligji, përcaktohet kompetenca dhe procedura për dhënien e tyre. Sipas pikës 2, të kësaj dispozite, masa e parashikuar në germën a) të nenit 58, jepet nga eprori direkt i nëpunësit, ndërsa masat e parashikuara në gerrat b), c) dhe ç) jepen nga Komisioni Disiplinor, për çdo nëpunës civil në institucion.

Në referim të pikës 10, të nenit 59, të ligjit në fjalë, është parashikuar se, Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregullat e hollësishme të procedurës disiplinore, si dhe rregullat për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor. Ky detyrim ka gjetur zbatim me miratimin e Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*”, i ndryshuar.

Konkretisht, në aktin nënligjor që rregullon disiplinën në shërbimin civil, (VKM nr.115/2014), në kreun I “Organet Disiplinore”, pika 1, përcaktohet se:

“Organet disiplinore, sipas ligjit, janë: Komiteti Kombëtar i Përzgjedhjes, për anëtarët e TND-së (KKP); komisioni disiplinor (KD), për nëpunësit e tjerë, dhe eprori direkt”.

Më tej, me qëllim zbatimin e unifikuar të rregullave dhe procedurës administrative disiplinore, nga ana e institucioneve të administratës shtetërore, Departamenti i Administratës Publike ka nxjerrë Udhëzimin nr. 01, datë 21.01.2025, “Për organet disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Në rastin konkret, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe bazës ligjore të cituar më lart, sa i takon pretendimeve të ngritura nga nëpunësja Eltona Josifi, rezulton se:

Së pari, sa i përket organit administrativ i cili ka tagrin për nisjen e ecurisë disiplinore, në pikën 7, të Udhëzimit nr. 01, datë 21.01.2025, “Për organet disiplinore dhe Procedurën e Shqyrtimit të Shkeljeve Disiplinore”, të DAP, parashikohet se, eprori i drejtpërdrejtë, në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, e vlerëson paraprakisht atë, bën vlerësimin e shkeljeve disiplinore me faj, të pretenduara përkundrejt nëpunësit civil dhe i klasifikon ato.

Gjithashtu, në këtë akt nënligjor, në pikën 3/2/ç, parashikohet se: epror i drejtëpërdrejtë për të gjithë nëpunësit e pozicioneve të tjera është Drejtori i Drejtorisë, që për këtë nëpunëse është Drejtori i Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit, pozicion në të cilin aktualisht është e emëruar nëpunësja Gentjana Duka.

Në rastin në fjalë, me anë të aktit nr. 649 prot., datë 26.01.2026, me lëndë: “*Kërkesë për ngritjen e Komisionit Disiplinor*”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, eprori direkt ka kërkuar ngritjen e Komisionit Disiplinor për nisjen e ecurisë disiplinore, për shkak të kryerjes së shkeljeve me faj gjatë ushtrimit të detyrës, në kuptim të nenit 57, pika 2, germa a), b) c) dhe ç, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Së dyti, në vijim të sa më sipër, me urdhrin nr. 34, (nr.649/1 prot.), datë 26.01.2026, “*Për ngritjen e Komisionit Disiplinor*”, të Kryetarit të Bashkisë, është ngritur Komisioni i Disiplinës, sipas përcaktimit të pikës 2, të kreut I, “*Organet disiplinore*”, të vendimit nr.115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*”, i ndryshuar, me përbërje si më poshtë, vijon:

1. Znj. Sofika Rexhepi – Nëpunësi më i lartë civil në institucion (*Kryetar*);
2. Znj. Gentjana Duka – Eprori direkt i nëpunësit për të cilin ka filluar procedura (*Anëtar*);
3. Z. Ganiart Eminaj – Nëpunësi më i vjetër civil (*Anëtar*);
4. Z. Ermal Zylfo – Nëpunësi më i vjetër civil (*Anëtar*);

5. Znj. Dorina Tallo –Drejtuesi i njësisë së burimeve njerëzore (*Anëtar*);

Nga verifikimi i akteve të emërimit në pozicionin e punës, për secilin anëtar, rezulton se, përbërja e Komisionit është e rregullt, e po ashtu edhe ligjshmëria e ndërtimit të këtij mekanizmi, në raport me kërkesat e ligjit.

Sa i takon procedurës së ndjekur nga Komisioni Disiplinor për hetimin administrativ të këtij rasti, konstatohet se, me shkresën nr. 649/2 prot., datë 26.01.2026, “Njoftim për shqyrtimin e shkeljes disiplinore”, **nëpunësja është njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore** për shkelje shumë të rënda të disiplinës në shërbimin civil, parashikuar nga pika 1/a, dhe pika 2 a), b), c) dhe ç) e nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke i lënë asaj, mundësinë për paraqitjen e pretendimeve dhe sqarimeve përkatëse me shkrim, brenda datës 29.01.2026 dhe në seancën dëgjimore që do të zhvillohej në datën 02.02.2026, ora 11:30, në ambientet e Bashkisë Kolonjë. Mbështetur në akt konstatimin nr. 649/4 prot., datë 26.01.2026, “*Për refuzimin e marrjes së “Njoftim për shqyrtimin e shkeljes disiplinore”*”, të mbajtur nga nëpunësja e protokollit Ina Hamzaj, provohet se nëpunësja Eltona Josifi ka refuzuar të marrë shkresën nr. 649/2 prot., datë 26.01.2026, “*Njoftim për shqyrtim të shkeljes disiplinore*”, duke mos nënshkruar në librin e protokollit.

Punonjësja e protokollit znj. Ina Hamzaj deklaron se ka bërë përpjekje për t’i dorëzuar shkresën nëpunëses së proceduar për të dytën herë në prani të punonjësit Origest Lifo, me detyrë “*Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve*” dhe punonjësit Enea Jorgji, me detyrë “*Drejtor i të Ardhurave dhe Tatim Taksave*”, duke hartuar më pas aktin që dokumenton faktin e refuzimit. Ky akt është nënshkruar nga të gjithë nëpunësit e përmendur më sipër.

Në seancën dëgjimore të caktuar nga Komisioni Disiplinor, për shqyrtimin e shkeljes së pretenduar, rezulton se nëpunësja në procedim nuk ka qenë prezent (*vërtetuar me procesverbalin nr.06, (nr.786 prot.), datë 02.02.2026*), si edhe nuk e ka dërguar qëndrimin e saj në lidhje me këtë ecuri disiplinore.

Në vijim, organi disiplinor, në mbështetje të hetimit administrativ të kryer në këtë rast, ka arritur në përfundimin se, punonjësja në fjalë, ka kryer shkelje shumë të rënda disiplinore, parashikuar në pikën 1/a, dhe pikën 2 a), b), c) dhe ç) të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe me këtë motivacion, në përfundim të shqyrtimit të procedurës disiplinore, me vendimin nr. 05, (nr.794 prot.), datë 02.02.2026, ka dhënë masën disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, për nëpunësen këtë punonjëse.

Në vijim, me vendimin nr. 06, (nr.796 prot.), datë 02.02.2026, “*Për lirim nga shërbimi civil*”, të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, në mbështetje të vendimit nr. 05, (nr. 794 prot.), datë 02.02.2026, të Komisionit të Disiplinës, nenit 63, germa b) dhe nenit

66, të ligjit të shërbimit civil, nëpunësja Eltona Josifi është liruar nga shërbimi civil. Duke e vlerësuar nga pikëpamja formale, aktin e nxjerrë nga njësia përgjegjëse, konstatohet se, emërtimi i tij është i gabuar, pasi titulli i aktit duhet të jetë: *“Përfundim i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dhënies së masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”,* çka duhet të mbahet në vëmendje në të ardhmen.

Më tej, në mbështetje të akteve të nxjerra nga Komisioni i Disiplinës dhe njësia përgjegjëse e institucionit, Kryetari i Bashkisë, me urdhrin nr. 49, (nr. 835 prot.), datë 03.02.2026, *“Për shkarkimin nga detyra të specialistes së financës”,* ka ndërprerë marrëdhëniet financiare të institucionit me nëpunësen. Ky akt i është njoftuar edhe nëpunëses, e cila e ka nënshkruar marrjen në dorëzim në librin e protokollit të Bashkisë Kolonjë, (marrje e shkresës nr. 49, (nr. 835 prot., datë 03.02.2026, në orën 14:13).

Së treti, rezulton se është respektuar parimi i përshkallëzimit dhe individualizimit të masës disiplinore, nisur nga fakti se, në ngarkim të nëpunëses Eltona Josifi është dhënë edhe më parë masë disiplinore *“Vërejtje”,* me vendimin nr. 42, (nr. 6041 prot.), datë 27.10.2025, *“Vendim përfundimtar”,* dhënë nga eprori direkt.

Sipas nenit 60, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”,* i ndryshuar, ku parashikohet se, Komisioni Disiplinor, për përcaktimin e masës disiplinore duhet të bazohet në:

- a) shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj;
- b) shkallën e fajësisë;
- c) ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashuara, sipas nenit 61 të këtij ligji, si dhe, në pikën 2, të këtij neni, ku sanksionohet se masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer, rezulton se, Komisioni Disiplinor ka marrë në konsideratë elementët e përcaktuar në pikën 1, të nenit 60, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, për të marrë një masë në përputhje me shkallën e fajësisë së nëpunëses, pasojave të ardhura, si dhe masave të mëparshme të dhëna në ngarkim të saj, duke vendosur më pas, masën disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”.*

Nisur nga përmbajtja e dokumentacionit në të cilin materializohet procedura disiplinore, arrihet në konkluzionin se, nga pikëpamja procedurale janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit, duke filluar nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore; kërkesës për fillimin e ecurisë; vënies në dijeni për këtë fakt të nëpunëses që pretendohet se ka kryer shkeljen; respektimi i të drejtës për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur; dhe administrimi i provave materiale të nevojshme, e deri në marrjen e vendimit përfundimtar nr. 05, (nr. 794 prot.), datë 02.02.2026, nga ana e Komisionit të Disiplinës.

Në këto kushte, arrihet në përfundimin se, akti për dhënien e masës disiplinore *“Largim nga shërbimi civil,* në ngarkim të nëpunëses Eltona Josifi është kryer në përputhje me procedurat e kërkuara nga ligji për nëpunësin civil.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, të filluar në bazë të informacionit nr. 258 prot., datë 09.02.2026, të paraqitur nga nëpunësja Eltona Josifi, pasi nuk janë konstatuar parregullsi në veprimet administrative të kryera nga subjektet e ngarkuara prej ligjit, gjatë realizimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të kësaj nëpunëseje.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Bashkisë Kolonjë, si dhe nëpunësja Eltona Josifi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)